



Shkruan: Valmir Krasniqi

"Na doli kjo makinë e na fiku " pat thënë si në shaka profesori i jonë i ndjerë, akademiku Muharrem Berisha para pak vitesh . Ai e kishte fjalën për internetin si mjet komunikimi dhe informimi global . Profesori e vlerësonte si të tillë internetin kur e kishte fjalën për informimin nga ai në të arriturat shkencore të ligjëruesve tonë dhe punëtorëve shkencorë që punojnë në UP , duke filluar nga rektorati e teposhtë . Për t'u bindur thellësisht në fjalën e profesor Muharrem Berishës , jam interesuar disa herë dhe kam kërkuar në GOOGLE emrat e ligjëruesve tonë dhe të shumë prej punëtorëve shkencorë të UP , e te shumica ka dalë se nuk iu figuron emri në asnjë revistë , kurse të disave që mbajnë titullin e profesorit ordinar , iu figuron emri vetëm në një ose dy punime (të cilat kanë fituar shumë herë vlerësim negativ nga reviuja e bërë nga ndonjë personalitet shkencor) .

Për ta shtuar edhe më shumë dëshpërimin tim në këtë drejtim , më ndodhi ta kam fatin që këtyre ditëve të fitojë një qasje në Scoups në afat prej 30 ditësh nga shtëpia botuese me prestigj ELSIVIER ([http : www . elsevier . com](http://www.elsevier.com)) , nga ku mësova shumë gjëra rrëqethëse . Në Scoups , e cila indeksin revistat më të mira shkencore në çdo lëmi , është trishtues fakti se në emrin e Universitetit të Prishtinës gjenden vetëm 194 dokumente shkencore të 186 autorëve nga Kosova . Është për te të ardhur inati , por është një realitet se në emrin e Universitetit të Beogradit , sipas Scoups , gjenden 14917 dokumente shkencore të 6682 autorëve .

Logjikisht mund të parashtrojmë një pyetje se çfarë kontributi mund të japin njerëzit në ngritjen e cilësisë së studimit dhe në avancimin e një institucioni akademik siç është UP , e vet për veti nuk dijnë çka është shkencë . Me fjalë tjera , mund të themi edhe më çartë , si mund të kontribuojë një njeri në shkencë kur vet nuk merret me shkencë . Mirëpo , praktika është ajo që nuk na lejon të fshehim realitetin , e kjo po shihet çartë nga gjendja e krijuar në UP, nga ku dalin kadro të fushave të ndryshme me një përgatitje shumë të dobët në aspektin profesional dhe shkencorë . Një thënie e urtë thotë : " Realiteti është mjaft i hidhur , por është realitet " , e

realiteti në të cilin gjendet UP është mjaft brengosës dhe është një thikë e ngulur në shpinë për krejt popullin e Kosovës . Në emër të reformimit të UP , klane të caktuara e kanë sjellë atë në një humnerë , nga e cila duhet mund i madh për të dalë .

Është poshtërim për një institucion siç është UP , të udhëhiqet nga njerëzit , siç janë :

Prof. Dr . Mujë Rugova , rektor

Prof. As . Basri Çapriçi , kryetar

Prof . Dr . Abdullah Aliu

Prof . As . Ilire Vinca

Prof . As . Marian Dema

Prof . Dr . Nijazi Ibrahim

Prof . As . Agim Zogaj

Prof . As . Gani Dragusha

Prof . As . Milazim Krasniqi

Prof . As . Nuri Bexheti

nga të cilët në Scoups kishte vetëm dy dokumente shkencore , dhe ato i takonin rektorit Mujë Rugova , ndërsa të tjerët ishin pa asnjë artikull shkencor në Scoups . Siç duket këta njerëz nuk kanë kohë të merren me shkencë dhe çështje profesionale , sepse ata të vetmin problem e kanë karrikën për ta fituar në rektorat , e atë duke manipuluar me vota të keqpërdorura nga njerëz të Unionit të Studentëve si dhe OJQ – ve të ndryshme që veprojnë brenda UP . Shkelja e Statutit të UP shihet çartë nga këta njerëz , pasi që iu lejohen tituj shkencorë njerëzve që nuk kanë numër të mjaftueshëm punimesh në revista me recension ndërkombëtar ashtu siç parashihet në Statut .

Gjendjen e mjerë të Këshillit Drejtues të UP e kam parë edhe në vendimin me shkrim që më kanë lëshuar (Ref . nr 2 / 769) ku më refuzohet kërkesa për përkrahje financiare për kontributin e madh shkencor që kam dhënë në fushën e matematikës me publikimin e shumë punimeve në revista me prestigj ndërkombëtar si dhe me qëllim të realizimit të planeve shkencore që i kam për të ardhmen . Nga përmbajtja e këtij vendimi çartë vërehet se këta njerëz i luftojnë haptazi njerëzit e shkencës e i përkrahin vetëm ata të cilët janë të njëjtë sikurse lloji i tyre . Përfundimisht mund të them se njerëzit e tillë çfarë e udhëheqin momentalisht UP janë kancer për këtë institucion i cili është arterie kryesore e zhvillimit intelektual të popullit tonë . Fundja , mua të vetmen gjë që mund të ma bëjnë këta njerëz është të më refuzojnë kërkesën për ndihmë financiare , ashtu siç kanë bërë , sepse bashkëpunimin me kolos të shkencës si dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore (siç ishte ajo para një muaji në Sofje të Bullgarisë) , këta nuk mund të ma ndalin . Por , po më dhimbset populli i Kosovës të cilin këta e lënë në terr të plotë intelektual ,si dhe po më dhimbset UP të cilin këta njerëz po e poshtërojnë si në vend ashtu edhe në nivel ndërkombëtar .

Autori është menagjer editorial në institutin ndërkombëtar për publikime shkencore ILIRIAS.